

## 2. MJETET (AKTIVET), DETYRIMET DHE KAPITALI

### 2.1. NOCIONI I MJETEVE (AKTIVEVE), DETYRIMEVE DHE KAPITALIT TEK SUBJEKTET EKONOMIKE

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore lidhet ngushtë me zhvillimin e mjeteve, çdo ndryshim apo përparim që kryhet në mjete ndikon edhe në marrëdhëniet shoqërore dhe në procesin e prodhimit. Historia e përparimit të shkencës dhe teknikës zë fill nga zhvillimi i veglave më primitive gjer tek përdorimi i sistemit automatik dhe elektronik.

#### 2.1.1. Mjetet (aktivet- asetet)


Për kryerjen e çfarëdo pune subjekti ekonomik duhet të disponojë me mjete. Mjetet e një subjekti ekonomik paraqesin faktorin kryesor material për kryerjen e detyrave të parashtruara. Mjetet nevojiten për të kryer detyrën në riprodhimin e të mirave materiale dhe e ndihmojnë njeriun që të veprojë mbi lëndën e punës. Mjetet duhet të jenë në përputhje me madhësinë e detyrave, që do të thotë se për kah sasia dhe cilësia ato duhet të jenë të mjaftueshme.

Mjetet e subjektit ekonomik i përfshijnë të gjitha të mirat materiale të shprehura në vlerë, me të cilat disponon një subjekt ekonomik. Pra, mjetet paraqesin të gjitha ato vegla, pajime apo instrumente me të cilat njeriu shërbehet gjatë procesit të prodhimit të të mirave materiale. Mjetet qëndrojnë në mes njeriut dhe objektit të punës dhe njëherit ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit në procesin e prodhimit. Për nevojat e ndryshme ndërmarrjet posedojnë mjete të llojeve të ndryshme. Sa i përket cilësisë dhe sasisë të mjeteve ato duhet ti përshtaten veprimtarisë të subjektit ekonomik. Lloji dhe vëllimi i mjeteve dallojnë nga ajo se a është në pyetje subjekt prodhues, tregtar apo shërbyes; subjektet prodhuese dallojnë nga ajo se a janë subjekte industriale, bujqësore, ndërtimore etj.

**Mjetet janë burim (resurs) të cilën e kontrollon subjekti ekonomik si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën dhe nga i cili në të ardhmen priten rezultate pozitive.**

Mjetet me të cilat disponon një subjekt ekonomik gjatë punës duhet t'i shfrytëzojë në mënyrë racionale dhe sipas funksionit që e ka në procesin e riprodhimit, me qëllim që ti rrisë sa më tepër rezultatet e punës. Sipas përkufizimit ekonomik të pronës në subjektin ekonomik, në njërën anë qëndron një grup i mjeteve të ndryshme, që përdoren dhe që janë në funksion për kryerjen e detyrave afariste në subjektin ekonomik, ndërsa në anën tjetër, ajo është pronë sipas origjinës së saj, dmth. kujt i takon dhe kujt do ti takojë në rast të ndërprerjes së punës të subjektit ekonomik.

**Që të konsiderohen si mjete këto duhen plotësuar këto kritere:**



- 
- **detyrimisht duhet të jenë në pronësi ose nën kontrollin e subjektit,**
- **duhet të kenë vlerë,**
- **duhet të jenë të furnizuara sipas shpenzimeve matëse.**

Mjetet mund të përdoren të vetme ose të këmbehen me mjete tjera, mund të përdoren për shlyerjen e detyrimeve dhe tu ndahen pronarëve të subjektit ekonomik. Të dhënat apo informatat



mbi mjetet (aktivet) kanë një rëndësi të madhe në orientimin e afarizmit në vijim apo për parashikimet e ardhshme të subjektit ekonomik, në kushtet e tregut të lirë e global të cilat janë tejet dinamike. Me anë të informatave përcaktohet shfrytëzimi racional dhe efikas i mjeteve të subjektit afarist. Këto informata, zakonisht, në kuadër të subjektit ekonomik, i siguron dhe i jep shërbimi i kontabilitetit.

Një nga problemet më kryesore në kontabilitet është përcaktimi i vlerës së mjeteve respektivisht aseteve tek një subjekt ekonomik. Parimi i përgjithshëm kontabël kërkon që vlera e


mjeteve më mirë të shprehet sipas shpenzimeve të furnizimit se sa sipas vlerës përlllogaritëse në treg. Arsye tjetër, që në kontabilitet përdoret vlera sipas shpenzimeve furnizuese në vend të vlerës së tregut është se mjetet blehen për punë e jo për shitje. Gjithashtu vlera furnizuese lehtë mund të dokumentohet, ku çdo auditor i jashtëm lehtë dhe saktë mund ta përcakton vlerën e mjeteve sipas shpenzimeve të furnizimit. Vlera e tregut për mjetet ndryshon gjithmonë dhe vlerësimi i çmimit sipas të cilit do të mund të shiteshin mjetet, në të shumtën e rasteve është mendim apo vlerësim personal. Në ditën kur mjetet janë furnizuar, vlera e furnizimit dhe e tregut zakonisht janë të njejta.

Mjetet-aktivet apo pasuritë, në përgjithësi ndahen në dy grupe themelore:

**1. MJETET KRYESORE -  
AKTIVET AFATGJATA -**

**2. MJETET E XHIROS- AKTIVET  
AFATSHKUTA - AASH**

Sipas ligjit kontabël në fuqi dhe përbërjes së tyre, mjetet kryesore (themelore) ndahen në gjashtë grupe:



**I. Investimet jomateriale** - këto mjete paraqesin të drejtën apo shpenzimet e bëra që duhet të kapitalizohen për në periudhë më të gjatë kohore. Duke u nisur nga të arriturat shkencore dhe zgjerimi i aktiviteteve paraqitet nevoja edhe për lloje të tjera të mjeteve jomateriale që i quajmë investime-deponime jomateriale. Si investime jomateriale konsiderohen: Shpenzimet (të dhënat) për zhvillim; Goodwill (nami i mirë); Konçesionet, patentat, liçencat, markat tregtare dhe shërbyese; Softveri dhe të drejtat tjera; Avanse (paradhënje) për furnizimin e mjeteve jomateriale; Mjetet jomateriale në vijim (përgatitje, proces); Mjetet tjera jomateriale; Barazimi vleror i mjeteve jomateriale dhe Amortizimi i akumuluar i mjeteve jomateriale.

**II. Investimet materiale** - Shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë kryesore të subjektit ekonomik të asaj veprimtarie për të cilën është krijuar subjekti. Këto mjete njëherit janë mjetet më të rëndësishme dhe mungesa e tyre në subjektin ekonomik jo vetëm që do ta vështirësonte

mirëvajtjen e punës por njëherit edhe do ta pamundësonte atë. Mjetet (investimet) materiale ndahen në: Objektet ndërtimore; Pajimet dhe makinat; Veglat, inventari i reparteve dhe zyrave, mobijliet dhe mjetet transportuese; Mjetet tjera materiale; Mjetet (investimet) materiale në përgaditje (ndërtim); Avanset (paradhëniet) për furnizimin e mjeteve materiale; Barazimi (nivelizimi) vleror i mjeteve materiale; Amortizimi i akumuluar i mjeteve materiale; Mjetet tjera afariste dhe Mjetet biologjike.

**III. Investimet në patundshmëri-** janë mjete afatgjata të rëndësishme në kryerjen e detyrave dhe detyrimeve të subjektit ekonomik. Në këto mjete bëjnë pjesë: Investime në patundshmëri për qera, Investime në patundshmëri për shkak të rritjes së kapitalit, Investime në patundshmëri në përgatitje; Avanse për investime në patundshmëri; Barazimi vleror i investimeve në patundshmëri; Amortizimi i akumuluar i investimeve në patundshmëri

**IV. Plasmane financiare afatgjata** - janë lloj i veçantë i mjeteve kryesore me perspektivë të rëndësishme dhe me tendencë rritëse në praktikën tonë. Janë avancime financiare afatgjata financiare të cilat i bënë subjekti ekonomik me ndonjë subjekt tjetër ekonomik, me të cilën gjen interes të përbashkët, apo avancime në letra me vlerë, kredi të dhëna afatgjate etj. Në këtë grup mjetesh themelore bëjnë pjesë: Investime në filialë; Investime në shoqërit dhe në shoqërit me kontroll të përbashkët; Hua dhe kredi afatgjata të shoqërive të ndërlidhura në vend dhe jashta vendit; Hua dhe kredi afatgjata të dhëna në vend dhe jashta vendit; Mjetet financiare që ruhen për maturim, Mjete financiare në dispozicion për shitje; Mjete financiare sipas vlerës objektive nëpërmjet fitimit apo humbjes; Kaucione dhe depozita afatgjata të dhëna në vend dhe jashtë vendit; Mjetet tjera financiare afatgjata; Barazimi vleror i mjeteve financiare afatgjata.

**V. Kërkesa afatgjata-** në këto mjete bëjnë pjesë: Kërkesa afatgjata nga shoqërit e ndërlidhura në bazë të shitjes; Kërkesa afatgjata nga shoqërit e pandërlidhura në bazë të shitjes me kredi; Kërkesa afatgjata në bazë të qerasë – qirasë financiare; Kërkesa afatgjata në bazë të konfiskimit (forfetingut); Kërkesa afatgjata në bazë të garancionit të dhënë; Kërkesa afatgjata të kontenstuara dhe të rezikuara; Kërkesa afatgjata për avanset e dhëna; Kërkesa tjera afatgjata; Barazimi (revalorizimi) i kërkesave afatgjata.

**VI. Mjete financiare të prolonguara** - Përbërja strukturale e mjeteve themelore është tejet e rëndësishme për çdo subjekt ekonomik. Arsyeja qëndron në faktin se duhet pasur një pasqyrim të duhur të mjeteve të cilat i duhen subjektit ekonomik në momente të caktuara kohore, për të parë edhe nivelin e efikasitetit të tyre.

Mjetet kryesore përfshijnë pasurinë materiale dhe jomateriale të subjektit ekonomik me të cilat synon të arrij detyrat e parashtruara në afat më të gjatë kohor. Sipas thelbit të tyre ekonomik ato janë mjete me afat të gjatë përdorimi. Struktura e mjeteve kryesore është e ndryshueshme, varësisht nga lloji i veprimtarisë së subjektit ekonomik.


**Mjetet e xhiros** janë pjesë e mjeteve afariste të subjektit ekonomik, të nevojshme për kryerjen e detyrave në aktivitetin prodhues apo qarkullues. Karakteristikë e këtyre mjeteve është se gjatë një cikli të prodhimit tërësisht shpenzohen dhe e ndërrojnë formën e tyre. Gjatë prodhimit ata transformohen tërësisht në prodhimin e ri dhe njëkohësisht e bartin vlerën e tyre tek ai produkt i gatshëm. Pas përdorimit mjetet e xhiros kur më nuk mund të kthehen në formën paraprake. Mjetet e xhiros, më së paku një herë në vit, qarkullojnë në kuptim të ndryshimit të formës së tyre- nga paraja, nëpërmjet mallit, përsëri kthehen në formën e parave. Për dallim nga mjetet kryesore të cilat harxhohen në shumë cikle të riprodhimit, mjetet e xhiros e kanë koeficientin e rreth xhirimit më të madh se një. Ndryshimi i shpeshtë i formës është karakteristikë themelore e mjeteve xhiruese. P.sh. ndërmarrjet tregtare me mjetet monetare blejnë mall tregtar dhe pastaj atë mall tregtar e shesin dhe e shndërrojnë përsëri në para.

Në mënyrë skematike kjo mund të paraqitet kështu:



Tek ndërmarrjet prodhuese cikli i shndërrimit të mjeteve nga një lloj në tjetrin është më i zgjeruar, për shkak se ata përveç ciklit të furnizimit të materialeve dhe shitjes së produkteve të gatshme kryejnë edhe prodhimtarinë.

E tërë kjo në mënyrë skematike mund të pasqyrohet kështu:



Shpesh, tek subjektet tona ekonomike, me mjetet e xhiros nënkuptohet lënda e parë dhe materiali, gjë që nuk është në rregull, sepse në mjetet e xhiros bëjnë pjesë edhe mjete tjera siç janë parat, kërkesat dhe rezervat.

Mjetet e xhiros paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 3** MJETET E XHIROS ( QARKULLUESE)

<b>PARATË</b>	<b>KËRKESAT</b>	<b>STOQET</b>
<b>1.MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET</b>	<b>1.KËRKESA NGA SUBJEKTET E NDËRLIDHUR</b>	<b>1. STOQET. E LËNDËVE TË PARA DHE MATERIALIT</b>
a. Xhirollogaria	<b>2. KËRKE.NGA BLERËSIT</b>	a.Stoqet e lëndëve të para
b.Mjetet monetare të ndara dhe akreditivi	a. Kërkes.nga blerë. Në vend	b.Stoqet e materialeve
c. Mjetet monetare në arkë	b. Kërkes.nga bler.jashta vendi	c.Lënda e parë dhe materialet në rrugë
c. Llogaria devizore	Kërkesa për avanset e dhëna, depozitat dhe kaucionet në vend	<b>2.INVENTARI I IMËT DHE AMBALLAZHI</b>
d. Akreditivi devizor	Kërkesa për avanset e dhëna, depozitat dhe kaucionet jashta vendit	a. Stoqet e inventarit të imët
dh. Arka devizore	Kërkesa nga punët specifike me subjekte të pandërlidhura	b.Invetari i imët në përdorim
e. Depozita- ekuivalente monetare	Kërkesa nga kamatat (kontraktues dhe ndëshkuese)	c.Stoqet e amballzhit dhe autogomave
e. Letra me vlerë	Kërkesa të dyshimta dhe kontestuese	ç.Amballazhi dhe autogom. në përdorim
f. Mjete tjera monetare	Kërkesa tjera	-----
g. Barazimi vleror i ekuivalenteve monetare	Barazimi (nivelizimi) vleror i kërkesave prej blerësve	<b>3. STOQET E PRODUKTEVE TË GATSHME</b>
	<b>3. KËRKESAT PREJ SHTETIT DHE INSTITUCIONEVE TJERA</b>	a.Stoqet e produkteve të gatshme
	Kërkesa nga tatimi i vlerës së shtuar – TVSH	b. Produkte të gatshme në depo të huaja
	Kërkesa nga mbipagesa e akcizave	c.Produkte të gatshme në shitore
	Kërkesa nga mbipagesa e doganës dhe të dhënave doganore	ç.Stoqet e pro.gatsh. jokonkurente
	Kërkesa tjera nga organet dhe institucionet tjera shtetërore	d.Stoqet e mbeturinave
	Barazimi (nivelizimi) vleror i kërkesave nga organet dhe institucionet tjera shtetërore	<b>4.STOQET E MALLRAVE</b>

	<b>4. KËRKESA PREJ TË PUNËSUARVE</b>	a.Stoqet e mallrave
	<b>5. KËRKESA TJERA</b>	b.Mallrat në depot e huaja
	<b>6. MJETET FINANSIARE AFATSHKURTËRA</b>	c. Mallrat në rrugë
	<b>7. SHPENZIMET E PARAPAGUARA (NKA)</b>	ç . Mallrat në shitore

Nevojat për mjete të xhiros paraqiten si të përhershme dhe të përkohshme. Nevojat e përkohshme subjekti ekonomik mund t'i plotësojë nga banka, duke marrë hua në formë të kredisë afatshkurtër, ndërsa nevojat e përhershme ai i plotëson duke bartë një pjesë të mjeteve nga fitimi që e realizon ai.

*Struktura e mjeteve të xhiros* nënkupton pjesëmarrjen e disa llojeve në tërësinë e mjeteve të xhiros. Normalisht që kjo strukturë përcaktohet nga më shumë faktorë siç janë: veprimtaria ekonomike e subjektit afarist, nga kushtet e afarizmit, nga likuiditeti, nga arkëtimet, nga organizimi i vetë subjektit ekonomik, etj. Po qe se subjekti ekonomik është subjekt prodhues, normalisht që pjesëmarrja e lëndëve të para dhe materialit është më e madhe se sa tek subjektet ekonomike tregtare, ku pjesëmarrja e mallit tregtar, zakonisht, është më e madhe se sa llojet tjera të mjeteve të xhiros.

Pra, sa më i shpejtë të jetë xhirimi i mjeteve të xhiros, së bashku me elementet e tjera të afarizmit, mundet të realizohet rentabilitet më i madh afarist, andaj edhe tentohet që të shpejtohet qarkullimi e mjeteve të xhiros.

*Optimizimi i mjeteve të xhiro-* struktura e mjeteve të xhiros tek subjekti ekonomik duhet të jetë në harmoni me veprimtarinë e subjektit. Sipas kësaj mjetet e xhiros duhet të jenë të prezantuar në aso madhësie, kohe dhe në aso forme lajmëruese që i kërkon procesi i pandërprerë i prodhimit, duke mos u prezantuar ndonjë formë e mjeteve të xhiros në dëm të formës tjetër. Mungesa sa do e vogël e mjeteve të xhiros e pamundëson apo e ndërpret procesin e prodhimit, por njëherazi edhe sasia e mjeteve të xhiros mbi nevojat e ngarkon subjektin ekonomik me shpenzime plotësuese. Prandaj, çdo subjekt ekonomik preferon të sigurojë një nivel optimal të mjeteve të xhiros.

Sigurimi i nivelit optimal të mjeteve të xhiros, subjektit ekonomik i krijon mundësinë e rezultatit maksimal me angazhim minimal të mjeteve të xhiros. Normalisht për tu arritur kjo



nevojitet një informacion i saktë mbi gjendjen e mjeteve të xhiros. Informacioni mbi qarkullimin e mjeteve të xhiros merret si për sasinë ashtu edhe për vlerën e tyre në periudha të ndryshme kohore për llojet, gjendjen faktike të mjeteve, nevoja për mjete, burimin e tyre, për kushtet me të cilat ato do të merren, etj.

Informata do të ndryshojë në përmbajtje varësisht nga aktiviteti afarist i subjektit ekonomik. Kjo nënkupton se informatat do të kenë përmbajtje tjetër, kur bëhet fjalë për subjekte prodhuese dhe të tjera kur bëhet për subjekte tregtare dhe krejtësisht tjera për subjekte shërbyese. Me anë të informatave që merren bëhen krahasime dhe fitohen njohuri mbi sasinë dhe shpejtësinë e qarkullimit të mjeteve të xhiros në afarizmin e subjektit të caktuar ekonomik.

Për aktivitetin e subjektit afarist është i rëndësishëm informimi për mangësitë apo tepricat në mjetet e xhiros, të cilat e rëndojnë pa nevojë aktivitetin e subjektit dhe e bëjnë atë joefikas. Është me rëndësi që informacioni të jetë i saktë dhe i marrë në kohën e duhur, çdo gabim në saktësi apo çdo vonesë në marrjen e informacionit shkakton marrjen e vendimeve të gabuara për mjetet e xhiros.

### **2.1.2. Detyrimet**

Detyrimet janë mjete të cilat një subjekt ekonomike i përdor përkohësisht sepse nuk janë të sajat. Ato paraqesin kapitalin e huaj të angazhuar në subjektin e caktuar ekonomik, kanë afatin e skadencës dhe detyrimisht duhet tu kthehen pronarëve. Pra, detyrimet janë borxhe. *Detyrimet e mjeteve tregojnë se nga rrjedhin dhe kujt i përkasin mjetet me të cilat disponon subjekti i caktuar.*


Detyrimet janë burime në të gatshme për financimin e aktiviteteve operative në subjektin ekonomik kur ato ndodhin si dhe kemi derdhjen (zvogëlimin) e tyre në të gatshme kur ato paguhen. Për çdo subjekt ekonomik është shumë e rëndësishme që të arrijë dhe të mbajë nivelin optimal të detyrimeve.

**Detyrimet janë obligime të tashme të subjektit ekonomik, të cilat rrjedhin nga ndodhitë e kaluara afariste dhe për shlyerjen e tyre priten të zvogëlohen mjetet e subjektit ekonomik.**



Të gjitha subjektet ekonomike sado të suksesshëme të jenë kanë detyrime, edhe ato shumë të suksesshmet e gjejnë arsyen që të blejnë mallra dhe stoqe me kredi sa sa ti paguajnë menjëherë. Detyrimet që rrjedhin nga blerja e mallrave apo e shërbimeve me anë të kredisë quhen detyrime ndaj furnitorëve (**llogari të pagueshme-LLP**), ndërsa personi apo subjekti ekonomik që e ka atë detyrim quhet debitor. Detyrimet që rrjedhin nga marja e mjeteve financiare si hua apo kredi quhen detyrime ndaj kredisë apo **dëftesa të pagueshme**.

Me parat e marura hua mund të blehen mallra të cilat mund tu shiten blerësve me një profit më të lartë, mund të shërbejnë për blerjen e pajimeve të reja më efikase që do ti mundësojnë subjektit ekonomik të prodhon më shumë dhe me shpenzime më të ulta. Kur subjekti mer para hua bëhet debitor i atij subjekti ekonomik. Kjo hua, apo ky borxh duhet të kthehet sipas mundësive në afatin e kontraktuar midis dy subjekteve konkret.



Për realizimin e qëllimit të tij, subjekti ekonomik detyrimisht shfrytëzon mjete të huaja, që në esencë paraqesin detyrime. Detyrimet, siç cekëm më lartë, janë pretendime ndaj aktiveve dhe burimeve të tashme dhe të ardhshme të subjektit ekonomik. Sipas parimit të kompetencës, në kontabilitet detyrimet do të regjistrohen kur ato ndodhin apo krijohen. Detyrimet, sipas afatit për kthimin e tyre, i ndajmë në:

### 1. DETYRIME AFATGJATA

### 2. DETYRIME AFATSHKURTA

**Detyrimet (obligimet) afatgjata** janë obligime që subjekti ekonomik u detyrohet subjekteve të tretë në një afat kohorë më të gjatë se një vit dhe janë një burim tepër i rëndësishëm i mjeteve në kuadër të subjektit ekonomik.

Në kuadër të detyrimeve afatgjate bëjnë pjesë: Detyrime afatgjate ndaj subjekteve të ndërlidhura; Detyrime afatgjate në bazë të huave dhe kredive; Detyrime afatgjate ndaj avancave, depozitave dhe kaucioneve; Detyrime afatgjate ndaj furnitorëve dhe Detyrime afatgjate ndaj letrave me vlerë.

**Detyrimet (obligimet) afatshkurta** janë obligime që i ka ndaj subjekteve të tretë në një afat kohorë më të shkurtër se një vit. Detyrimet afatshkurtra mund të përkufizohen si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti.

Këto detyrime burojnë nga aktiviteti i përditshëm i subjektit ekonomik. Në kuadër të detyrimeve afatshkurta bëjnë pjesë: Detyrime afatshkurtra në bazë të letrave me vlerë; Detyrime afatshkurtra ndaj furnitorëve dhe obligimet ndaj avansave, depozitave dhe kaucioneve; Detyrime afatshkurtra ndaj subjekteve të ndërlidhura; Detyrime afatshkurtra në bazë të kredive të marra; Detyrime afatshkurtra ndaj tatimeve, kontributeve dhe të dhënave tjera; Detyrime afatshkurtra për rroga, detyrime të tjera ndaj të punësuarve, dhe detyrime tjera; Prolongimi i pagesës së shpenzimeve dhe të hyra në periudhat e ardhshme - ndarje kohore pasive (NKP).

Çdo subjekt ekonomik bën analizën e detyrimeve që i ka ndaj personave të tretë, qofshin ato subjekte juridike apo ato fizike. Gjatë analizës duhet të jemi të sigurt se subjektet ekonomike llogarisin saktë kushtet dhe kufizimet që i imponojnë detyrimet dhe subjektet ekonomike kërkojnë rrugë për të pakësuar shumën e detyrimeve të raportuara në pasqyrat e tyre financiare.

### **2.1.3. Burimet e veta (kapitali i pronarit)**

Kapitali i pronarit përbën interesin e pronarit në subjektin ekonomik, apo investimin e bërë të pronarit në te.

**Kapitali i pronarit është ajo pjesë nga kapitali i tërësishëm që i qëndron në dispozicion subjektit ekonomik pa afate kohore, në aspektin e kthimit dhe pa asnjë lloj kufizimi, në aspektin e përdorimit.**

Pra, kapitali i pronarit tregon pjesën e mjeteve (aktiveve) të subjektit ekonomik të përballuar nga vetë pronari apo pronarët e tij. Ky kapital mund të rrjedhë nga themeluesi, nga ortakët, nga kapitali aksionar apo si rezultat i punës së suksesshme të subjektit ekonomik në të kaluarën, respektivisht nga rezultati financiar. Në terminologjinë e kontabilitetit kontributi (investimi) i pronarit quhet **“Kapitali i pronarit”** apo **“Kapitali neto”**. “Kapitali neto” mund të definohet si kërkesat e pronarit mbi mjetet e subjektit ekonomik.

Kapitali në subjektin ekonomik paraqet mjet të cilin e investon pronari (apo disa pronar) si dhe është rezultat i punës së suksesshme të subjektit ekonomik në të kaluarën.



Kapitali klasifikohet siç vijon: Kapitali i regjistruar i papaguar; Kapitali themelor i regjistruar i paguar, Premisat e aksioneve të emetuara (primi emisionar); Rezerva revalorizimi; Fitimi i akumuluar dhe fitimi nga viti financiar; Humbja e bartur dhe humbja nga viti financiar; Klasifikimi i kapitalit do të pasqyrohet edhe në mënyrë tabelare.

**Tabela nr.4** Klasifikimi i kapitalit

<b>KAPITALI I REGJISTRUAR I PAPAGUAR</b>	<b>KAPITALI THEMELUES I REGJISTRU I PAGUAR</b>	<b>PREMISAT E AKSIONEVE TË EMETUARA</b>	<b>REZERVA RIVALORIZIMI</b>
a.KRP – aksionet e rëndomta	Kapitali aksionar-aksionet e rëndomta	(primi emisionar)	Rezerva ligjore
b.KRP- aksionet prioritare	Kapitali aksionar-aksionet prioritare		Rez. për aksionet vetanake
c.Depozitat e regjistruara të papaguara	Depozita të ortakëve		Rezervat statutare
	Kapitali shtetëror etj.		Rezervat tjera

## 2.2. EKUACIONI THEMELOR KONTABËL

Subjektet ekonomike në mënyrë efikase duhet ta kryejnë procesin e riciklimit që të arrijnë qëllimin për të cilën edhe janë formuar. Për ta aritur këtë qëllim ata detyrimisht duhet të posedojë një sasi të caktuar mjete. Gjatë veprimtarisë afariste subjektet ekonomike hyjnë në marrëdhënie debitore - kreditore me persona të tretë, nga edhe rrjedhin detyrimet dhe kërkesat e ndryshme.

Raporti nëpërmes tre elementeve të ekuacionit kontabël, mjetet, detyrimet dhe kapitali mund të paraqitet në këtë mënyrë:

$$\mathbf{MJETET = DETYRIMET + KAPITALI I PRONARIT}$$

E shprehur shkurtimisht:

$$\mathbf{M = D + Kp}$$

Kjo përbën edhe ekuacionin themelor kontabël, i cili pasqyron marrëdhëniet që ekzistojnë midis mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të pronarit. Ekuacioni kontabël ve në dukje më mirë interesat e pronarëve ose investimet e tyre si më poshtë:

$$\mathbf{Kp = M - D \quad dhe \quad D = M - Kp}$$

Pikërisht ekuacioni kontabël e ka burimin dhe barazimin që rezultojnë midis dy anëve të bilancit, i cili **nuk duhet të priset** asnjëherë pavarësisht nga ndryshimi i gjendjes financiare e ndërmarrjes. Po qese  $M=16.000$ ;  $D=10.000$  dhe  $Kp=6.000$  do të kemi këtë ekuacion kontabël :

$$\mathbf{M = D + Kp \quad M - D = Kp \quad M - Kp = D}$$

$$\mathbf{16.000=10.000 +6.000; \quad 16.000 - 10.000=6.000 \quad ose \quad 16.000 - 6.000 =10.000}$$

Çdo ndërrim kontabël, pavarësisht se a është i thjeshtë apo i ndërlikuar, mund të shprehet me vlerat e saja në kuadër të ekuacionit themelor kontabël. Kuptimi i plotë dhe i saktë i kësaj baraspeshe dhe shfrytëzimi praktik i tij, janë të rëndësishëm për studentët dhe kontabilistët në përgjithësi.

Pavarësisht faktit se zhvillohet apo stagnon subjekti ekonomik, baraspeshimi ngel dhe çdo herë ruhet si e tillë. Çdo rritje e shumës së mjeteve detyrimisht përcillet me rritje të njëjtë nga ana e kundërt e baraspeshimit, respektivisht me ritjen e detyrimeve ose të kapitalit dhe e kundërta.

Regjistrimi i mjeteve (aktiveve) na tregon se cilët mjete i ka subjekti ekonomik, regjistrimi i kapitalit dhe detyrimeve na tregon se kush e ka furnizuar subjektin ekonomik me ato mjete. Të gjitha mjetet apo asetet që i ka subjekti ekonomi i ka furnizuar nga kreditorët dhe nga pronari. Prandaj edhe shuma e detyrimeve dhe kapitalit është e barabartë me shumën e mjeteve.

## **Pyetje**

1. Për çka i duhen mjetet nje subjekti ekonomik?
2. Çfar paraqesin mjetet?
3. Cilët kritere duhet plotësuar që të konsiderohen mjete?
4. Pse është e rëndësishme informata mbi mjetet?
5. Sipas parimit kontabël, cila vlerë përcaktuese e mjeteve afatgjata, është më e mire:  
a) vlera furnizuese apo b) vlera e tregut, dhe pse?
6. Çka janë dhe çka tregojnë detyrimet?
7. Cilët janë mënyrat sipas të cilave mund të shlyhen detyrimet?
8. Çka paraqet kapitali i pronarit?
9. Si i ndajmë mjetet : a \_\_\_\_\_ dhe b. \_\_\_\_\_ .
10. Numëro disa karakteristika të mjeteve kryesore?
11. Sipas cilëve kritere bëhet klasifikimi i mjeteve të xhiros?
12. Si ndahen mjetet e xhiros?
13. Nga cilët faktorë varet lartësia e mjeteve të xhiros?
14. Pse është i nevojshëm optimizimi i mjeteve të xhiros?
15. Çka janë dhe çfarë përfaqësojnë detyrimet?
16. Numëro disa detyrime afatgjata dhe disa afatshkurtëra?
17. Çka paraqet kapitali dhe numëro disa burime të saja?
18. Shëno formulën e ekuacionit themelor kontabël dhe jep tre shembuj me numëra?

Ushtrime:

1. Tek mjetet kryesore, shënoni para mjeteve jomateriale-JOM dhe mjeteve materiale shkrojnë M.

- \_\_\_ Shpenzimet (të dhënat) për zhvillim
- \_\_\_ Veglat, inventari i repartëve dhe zyrave, mobiliet dhe mjetet transportuese
- \_\_\_ Mjetet tjera materiale
- \_\_\_ Goodëill ( nami i mirë )
- \_\_\_ Konçesionet, patentat, liçencat, markat tregtare dhe shërbyese
- \_\_\_ Objektet ndërtimore
- \_\_\_ Mjetet jomateriale në vijim (përgatitje, proces)
- \_\_\_ Mjetet tjera jomateriale
- \_\_\_ Pajimet dhe makinat
- \_\_\_ Mjetet (investimet) materiale në përgatitje (ndërtim).

2. Identifikoni dhe shënoni mjetet (M), detyrimet (D) dhe kapitali (K).

- \_\_\_ 1. Stoqet e mallit tregtar
- \_\_\_ 2. Patentat
- \_\_\_ 3. Kapitali aksionar
- \_\_\_ 4. Toka
- \_\_\_ 5. Detyrimet ndaj doganës
- \_\_\_ 6. Inventari i imët
- \_\_\_ 7. Goodwilli
- \_\_\_ 8. Detyrimet ndaj neto rrogës
- \_\_\_ 9. Kërkesat nga blerësit (LLA)
- 10. \_\_\_ Objektet ndërtimore
- 11. \_\_\_ Detyrimet ndaj furnitorit (LLP)
- 12. \_\_\_ Xhirollogaria
- 13. \_\_\_ Stoqet e produkteve të gatshme
- 14. \_\_\_ Kapitali i pronarëve
- 15. \_\_\_ Pajimet
- 16. \_\_\_ Licencat
- 17. \_\_\_ Arka
- 18. \_\_\_ Kredit e dhëna afatgjata

3. Aplikoni ekuacionin themelor kontabël, në tabelën e poshtshënuar, për të llogaritur shumat që mungojnë.

Rastet	Totali i mjeteve (pasurisë)	Totali i detyrimeve	Totali i kapitalit
1	?	245.000	125.600
2	125.700	87.500	?
3	452.000	?	232.000
4	?	326.000	124.000
5	340.000	160.500	?

